



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:113435

Datë: 21.09.2021

Numri i dokumentit: 02194525

PA1.nr.1013/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit K.D., nga ..., për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 par. 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të dëmtuarës F.K., si dhe të mbrojtësit së të akuzuarit K.D., av. Engjëll Vërtopi, të ushtruara kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1558/2021, të datës 15.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 21.09.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat, e të dëmtuarës F.K., si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit K.D., av. Engjëll Vërtopi, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1558/2021, të datës 15.06.2021, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.1558/2021, të datës 15.06.2021, është shpallur fajtor i akuzuari K.D., për shkak të veprës penale ngacmimi nga neni 182 par. 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 300 Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në dy këste mujore, më së largu deri më dt. 5 të muajit vijues. Mundësia e pagesës me këste do të revokohet nëse i akuzuari nuk e paguan këstin me kohë.

Nëse revokohet dënimi me gjobë, dhe i akuzuari nuk mundet apo nuk do ta përmbush ose refuzon që ta paguaj dënimin me gjobë, atëherë i njëjti, në pajtim me të akuzuarin, mund ti zëvendësohet më punë në dobi të përgjithshme, ashtu që 8 orë puna në dobi të përgjithshme do të barazohen me 20 Euro të dënimin të shqiptuar me gjobë.

Po që se i akuzuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë i njëjti dënim do ti zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 15 ditësh, duke e llogaritur për çdo ditë të kaluar në burgim me nga 20 Euro, në kuptim të nenit 43 par. 3 të KPK.

E dëmtuara, F.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar,

- e dëmtuara F.K., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë,

- mbrojtësi i të akuzuarit K.D., av. Engjëll Vërtopi, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1029/2021, të datës 20.08.2021, duke u sqaruar përkritazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që e mbrojtësit së të akuzuarit K.D., Engjëll Vërtopi, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës të vërtetohet.

Përkundër asaj që Prokuroria e Apelit me shkresën PPA/II.nr.1029/2021, të dt. 09.09.2021 ka propozuar që të hedhet poshtë si e palejuar ankesa e të dëmtuarës F.K., e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se vepra penale ngacmimi nga neni 182 të KPK, bie në kuadër të kapitullit XVI Veprat penale kundër jetës dhe trupit, ashtu që në kuptim të nenit 381 par. 3 të KPPK, “i dëmtuari mund të ushtroj ankesë kundër aktgjykimit vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit...”, që nënkupton se mendimi i Prokurorisë së Apelit për hedhjen e ankesës së të dëmtuarës si të pa lejuar, është i pabazuar, dhe kolegji i kësaj gjykate, këtë çështje penale do ta shqyrtoj në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

Ankesat, e të dëmtuarës F.K., si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit K.D., av. Engjëll Vërtopi, nuk janë bazuara.

Meqenëse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin

394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës së të dëmtuarës F.K., aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se i akuzuari është dënuar në mënyrë të padrejtë, për arsye se deklaratat e dhëna nga ana ime kanë qenë të ekzagjeruara, për shkak se kam qenë impulsive. Në esencë i akuzuari K.D., nuk më ka dëmtuar në asnjë mënyrë, prandaj përfundimisht përmes kësaj deklarate, i kërkoj gjykatës që ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar përkritazi me vendimin për dënimin dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim sa më të butë.

Gjithashtu, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe nga mbrojtësi i të akuzuarit K.D., av. Engjëll Vërtopi, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se pretendimi se qëllimi i dënimit arrihet me dënimin me gjobë të lartë, është i pa pranueshëm. Gjykata e shkallës së parë nuk ka aplikuar në tërësi parimin e individualizimit të dënimit, çka nënkupton se nuk është e mjaftueshme që rrethanat lehtësuese të përmenden pa u vlerësuar drejtë. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, është dashur që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese, sikurse janë pranimiti i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën e kryer penale, sjellja e të akuzuarit pas kryerjes së veprës penale, rrethanat personale dhe karakteri e të akuzuarit, gjendjen shëndetësore, si dhe gjendjen financiare. Andaj, duke pasur parasysh rrethanat të cilat u përmendën, konsiderojmë se me një dënim më të butë, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit i paraparë në dispozita ligjore.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesat e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga pranimiti i fajësisë nga ana e të akuzuarit, për veprën penale e cila i vihet në barrë, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, dhe si rrethanë lehtësuese ka vlerësuar faktin se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka shprehur pendimin e tij për veprën e kryer penale, se ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, se është hera e parë që ka kryer veprë penale, si dhe i ka kërkuar falje palës së dëmtuar, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Nga ankesat, e të dëmtuarës F.K., si dhe e mbrojtësit së të akuzuarit K.D., av. Engjël Vërtopi, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2021:113435
Datë: 21.09.2021
Numri i dokumentit: 02194525

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.1013/2021, të datës 21.09.2021

Sekretarja juridike,
Fitnete Hoti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri